



Buletini Informativ

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Vlerësimi i nevojave trajnuese
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

Gusht 2020

Hyrje

Akademia e Drejtësisë edhe gjatë muajit gusht si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 ka vazhduar veprimtarinë e saj të dizajnuar në pajtim me masat dhe kriteret e përcaktuara për mbrojtje dhe parandalim të kësaj pandemie.

Karakteristikë e veçantë e këtij muaji është se aktivitetet janë më të pakta duke pasur parasysh edhe pushimet vjetore. Megjithatë aktivitetet duke përfshirë edhe trajnimet e vazhdueshme dhe fillestare janë realizuar përmes platformës ZOOM.

Përmes këtij buletini informativ në vijim pasqyrohen aktivitetet e në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për vitin 2021, takimet e ndryshme, si dhe aktivitetet e nga Programi i Trajnimeve Fillestare sipas sesioneve dhe moduleve trajnuese si dhe aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme të specifikuar sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, buletini përmban edhe njoftimin sa i përket kurseve trajnuese të realizuara në platformën e mësimit në distancë

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe aktivitetet e përbashkëta me donatorët dhe projektet

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë me ftesën e Komisionit Legjislativ, Mandate dhe Imunitete të Kuvendit të Republikës së Kosovës ka marr pjesë në takimin e radhës në të cilin është raportuar për procesin e punës dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2019. Në takim u ofruan përgjigje në pyetjet në lidhje me të arriturat në programin trajnues, statusin e AD-së, procesin e zgjedhjes së trajnuesve, buxhetin, si dhe në përgjithësi nevojën për mbështetje dhe fuqizim të AD-së. E veçantë e këtij raportimi ishte se konkluzionet përfundimtare të anëtareve të komisionit ishin pozitive dhe me vlerësim të lartë për punën e AD-së gjatë vitit 2019.

Në vazhdën e bashkëpunimit me miqtë dhe partnerët ndërkombëtarë gjatë muajit gusht ka pasur takime dhe koordinime me projektin e USAID-it / CJA (Aktivitete në Drejtësinë Komerciale), OSBE-në, organizatën ATRC, OPDAT dhe Ambasadën Britanike

Me projektin e USAID-it/ CJA (Aktivitete në Drejtësinë Komerciale), është diskutuar dhe janë konkretizuar modalitetet e publikimit të njoftimit/ konkursit për trajnues nga fusha e drejtësisë komerciale.

Në kuadrin e bashkëpunimit me OSBE-në janë zhvilluar takime me qëllim të përgatitjeve për

zhvillimin e Trajnimit për Trajnues i cili ka të bëjë me Hartimin e akteve akuzuese.

Në takimet me organizatën ATRC e financuar nga Ambasada Holandeze janë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për rastet e ndërlidhura me gjuhën e urrejtjes. Lidhur me këtë është nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit në fjalë.

Me Ambasadën e SHBA-së, konkretisht me përfaqësuesit e zyrës së ODAT-it janë zhvilluar takime me qëllim të përgatitjeve paraprake për trajnimin “Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme”

Në takimet me përfaqësues të Ambasadës Britanike, respektivisht udhëheqësit e projektit “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë” është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të AD-së dhe projektit në fjalë në fushën e ngritjes së komunikimit ndërmjet sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë civile, me theks të veçantë fuqizimi i AD -se në këtë fushë.

Memorandum i bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe Qendrës së Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

Më 25 Gusht 2020, Akademia e Drejtësisë dhe Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) nënshkruan marrëveshje



bashkëpunimi në kuadër të zhvillimit të trajnimeve në fushën e Krimeve të urrejtjes.

Ky projekt ka kohëzgjatje prej 1 viti, deri në Gusht 2021, dhe ka për qëllim që Akademia e Drejtësisë dhe ATRC të organizojnë trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë për ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në fushën e krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes.

Me anë të kësaj marrëveshjeje AD dhe ATRC dakordohen që ta ndihmojnë njëra tjetrën në zhvillimin e trajnimeve, në mbështetjen e njëra tjetrës në shkëmbimin e informatave të dalura nga trajnimet, të njoftojnë pjesëmarrësit rreth krimeve të urrejtjes dhe llojeve të tyre, të interpretohen dhe studiohen dispozitat e viktimave të dhunës së urrejtjes sipas Kodit Penal dhe ndryshimeve legjislative që kanë ndodhur etj.

Akademia e Drejtësisë synon që trajnimet që mbulojnë fushën e krimeve të urrejtjes t'i inkuadrojë në Programin Trajnues të vitit 2021.

Edhe pse një projekt jo shumë afatgjatë, Akademia e Drejtësisë dhe ATRC synojnë që bashkëpunimet mes tyre t'i zhvillojnë edhe në projekte tjera të cilat do ta ndihmonin sistemin e drejtësisë në luftimin dhe parandalimin e dukurive negative.



Takim me përfaqësuesit nga Projekti i Ambasadës Britanike “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë”

Më 27 gusht 2020, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, ka pritë në takim përfaqësuesit e Projektit të Ambasadës Britanike “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë”, z. Ken Taylor, Drejtor i Projektit, dhe z. David Wells, Ekspert për Zhvillim Institucional.

Në këtë takim, Drejtori fillimisht falënderoi Ambasadën Britanike për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Akademisë së Drejtësisë dhe institucioneve tjera të drejtësisë në Kosovë, njëherit i informoj lidhur me punën e Akademisë dhe avancimin e bashkëpunimit me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe akterët tjerë të sektorit të drejtësisë, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të sistemit të drejtësisë dhe

cilësisë së programeve në përgjithësi të cilat i ofron Akademia e Drejtësisë.

Duke e vlerësuar bashkëpunimin e deri tanishëm, përfaqësuesit e këtij projekti z. Taylor dhe z. Wells, njoftuan Drejtorin e AD-së rreth implementimit të Projektit si dhe konfirmuan edhe njëherë, se do të kenë një bashkë koordinim në mbarëvajtjen e aktiviteteve me qëllimin e përbashkët për tejkalimin e kësaj situatë të krijuar si rezultat i pandemisë, si dhe vazhdimin e bashkëpunimit për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë.



Vlerësimi i nevojave trajnuese


Aktivitetet e realizuara për vlerësimin e nevojave trajnuese

Në vazhden e aktiviteteve për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit Trajnues për vitin 2021 janë zhvilluar takime me kryetar të gjykatave dhe kryeprokuror të Prokurorive në të cilat janë identifikuar vështirësitë dhe problemet praktike në secilin regjion.

Përveç takimeve me subjektet në fjalë janë mbledhë propozimet nga pyetëtorët për vlerësim të dërguar paraprakisht në gjykata dhe prokurori. Në mbështetje të UNDP-së është realizuar edhe takimi me gjyqtarë dhe prokurorë për hartimin e kurrikulën trajnuese në fushën e mos diskriminimit.

Takimi me gjyqtarë dhe prokurorë për vlerësimin e nevojave dhe programit trajnues në fushën e diskriminimit

Më 3 gusht 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, në funksion të hartimit të programit trajnues për vitin 2021 adekuat me nevojat trajnuese për fushën e



diskriminimit, përmes platformës ZOOM kanë realizuar takimin e radhës me grupin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët vinin nga gjitha nivelet dhe regjionet e Kosovës.

Gjatë këtij takimi në fokus ishte përmbledhja e e cila përfshinte kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare në fushën e diskriminimit dhe mekanizmat institucional në mbrojtje nga diskriminimi, si dhe sfidat dhe problemet praktike në zbatimin e këtij legjislacioni, me theks të veçantë të Ligjit mbi diskriminimin dhe Ligjit për barazinë gjinore të Kosovës.

Gjatë diskutimeve u vunë në pah disa raste të diskriminimit për të cilat janë ngritur padi e të

cilat ende nuk e kanë marrë epilogun apo ende nuk janë vënë në punë për shkak të grumbullimit të lëndëve dhe faktit se nuk janë të klasifikuara si urgjente. Rastet kryesisht ishin nga personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu gjyqtarët potencuan se gjykatat ende nuk janë sfiduar me rastet e diskriminimit dhe kjo për shkak të kulturës dhe traditës. Megjithatë me rastin e diskutimeve ata theksuan nevojën për trajnime të specializuara dhe hartimin e manualeve dhe doracakëve sa i përket aspektit procedural se si ti qasen rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Me rastin e këtij takimi nga ky grup dolën rekomandimet për fuqizimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe zyrtarëve që merren me këtë fushë për të qenë më efikas dhe më funksional në mbrojtjen nga diskriminimi. Më tej u kërkua që pyetëtorin për vlerësim të nevojave trajnuese dhe zhvillimit të kurrikulës trajnuese ta plotësojnë dhe ta dërgojnë me tematikën konkrete bazuar në rastet më të shpeshta të diskriminimit që i hasin në praktikë.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Apelit dhe Themelor si dhe prokuror nga Prokuroria Themelore nga regjioni i Mitrovicës dhe Prishtinës.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Në periudhën raportuese, prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII-të kanë vazhduar intenzivisht trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse ku ata janë të emëruar për të kompensuar ditët e humbura gjatë fillimit të pandemisë nga Virusi Covid 19 në Kosovë.

Paraprakisht prokurorët e kanë përfunduar trajnimin teorik dhe me përmbushjen e trajnimit praktik sipas ditëve të realizuara në gusht, kjo gjeneratë ka përfunduar programin e

trajnimit fillestar ashtu siç është paraparë për 12 muaj.

Akademia e Drejtësisë pas përfundimit të programit ka filluar përgatitjet për kompletimin e dosjeve të prokurorëve në pajtim me rregulloren e PTF-së dhe do të dërgohet Komisionit për Vlerësimin e Performancës në Këshillin Prokurorial të Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Avancim mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë

Më 05 gusht 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) me përkrahjen e CEL - Qendra për Barazi dhe Liri për të drejtat e komunitetit LGBTI organizoj trajnimin me temë: “Avancimi mbi të drejtat e personave LGBTI në Kosovë” në kuadër të PTV-së. Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live nga ora 10:00-13:00.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me tematikën e respektimit të të drejtave në procedurat gjyqësore të personave LGBTI në Kosovë.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan temat në vijim: Hyrje në të drejtat e komunitetit LGBTI - standardet ndërkombëtare dhe korniza ligjore në Kosovë, Aspekti penal dhe civil i mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI. Në pjesën e dytë të trajnimit u trajtuan temat: Identifikimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga raste konkrete dhe roli i gjykatave në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të komunitetit LGBTI.

Me rastin e këtij trajnimi u zbërthyen edhe kuptimi i koncepteve kryesore siq janë: "orientimi seksual"; "Identiteti gjinor" dhe "karakteristikat seksuale"; “Krimi i urrejtjes”; dhe konceptet më të gjera të "homofobisë", "transfobisë", "stereotipizimit" dhe "diskriminimit". Kjo u theksua se përbën bazën për përqendrimin më teknik të ndjekjes së krimit të urrejtjes.

Në vazhdim u potencua se legjislacioni i Republikës së Kosovës është kompatibil me standardet ndërkombëtare në këtë lëmi. Një ashtu edhe gjykatat janë duke i trajtuar me

seriozitet dhe kujdes të shtuar këto raste. Por sundimi i ligjit është pengesë e zakonshme për Kosovën, madje edhe më shumë kur bëhet fjalë për mbrojtjen e komuniteteve të marginalizuara, veçanërisht të komunitetit LGBTI. Kjo është veçanërisht për shkak të vlerave tradicionale të shoqërisë dhe stigmatizimit të lartë shoqëror të lidhur me komunitetin LGBTI, që shtrihet drejtpërdrejtë edhe tek zyrtarët publik dhe zbatuesit e ligjit. Në një studim të kryer nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) mbi komunitetin LGBTI në Kosovë, u theksua se janë raportuar abuzime psikologjike dhe dhunë fizike të kryera nga zyrtarët në institucione dhe organizata. Ngjashëm, studimi tregon se komuniteti LGBTI në Kosovë ka raportuar diskriminim në arsim dhe zhvillim personal, në mbrojtje nga policia, dhe në qasje në shërbimet publike.


Në trajnim fokusi ishte në rëndësinë e angazhimit të ndjekjeve penale për të luftuar krimin e urrejtjes, konsiderimin e hershëm të ndikimit të krimeve të urrejtjes tek personat LGBTI dhe përqendrimi në kontekstin më të gjerë të diskriminimit dhe paragjyqimeve që personat LGBTI përjetojnë në Kosovë.

Gjithashtu u bë një prezantim gjithëpërfshirës i standardeve ndërkombëtare më të rëndësishme aktuale dhe legjislacionit kombëtar për të luftuar krimet e urrejtjes - dhe aplikimin praktik të këtyre të standardeve që mbështesin ndjekjen efektive të krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTI. Fokusi ishte veçmas tek viktimat për të ndjekur krimet e urrejtjes ndaj personave LGBTI dhe aftësitë kryesore të nevojshme për të mbledhur prova të motivit të paragjyqimit, elementet kryesore që diferencojnë krimet e urrejtjes nga krimet e zakonshme.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe u ofruan përgjigje në pyetjet dhe paqartësitë e ngritura për të gjitha aspektet e mbrojtjes së të drejtave të komunitetit LGBTI në sistemin gjyqësor dhe

prokurorial.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë dhe prokuror të nivelit Themelor nga gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnimi: Fazat e procedurës paraprake-hetimet proaktive dhe sigurimi i provave

Më 10 dhe 11 Gusht 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme realizoj trajnimin në formë virtuale me temë “Fazat e procedurës paraprake, hetimet proaktive dhe sigurimi i provave”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të procedurës paraprake dhe në zbatimin e hetimeve proaktive dhe sigurimin e provave.


Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan mënyrat se si sigurohen provat në procedurën paraprake, si duhet pasur kujdes në respektimin e afateve hetimore, pastaj mënyrat e aplikimit të masave të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit. Në vijim u trajtuan masat adekuate për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale si dhe trajtimi i dëshmitarëve dhe mbrojtja e tyre.

Vëmendje të veçantë kishin edhe marrja në pyetje dhe mënyra e marrjes së deklaratës nga i pandehuri, dëshmitari, i dëmtuari dhe nga eksperti. Gjithashtu gjatë trajnimit u trajtuan edhe hetimet pro aktive, paraqitja e kërkesave në gjykatës si dhe mundësia hetuese e veçantë.

Të gjitha këto çështje u trajtuan me kujdes të veçantë në mënyrë që në praktikë të gjinden zgjidhje logjike dhe të qarta.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar nga Gjykata e Apelit, gjyqtar dhe prokuror nga niveli Themelor nga gjitha regjionet e Kosovës.



Program i Specializuar Trajnimi: Shpërlarja e Parave Sesioni II

Më 12-13 gusht 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, përmes platformës Zoom realizoi sesionin e dytë të trajnimit me temë “Program i Specializuar Trajnimi - Shpërlarja e Parave.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe pjesëmarrësve tjerë në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me veprën penale të shpërlarjes (pastrimit) së parave.

Gjatë këtij sesioni u trajtuan teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave, mënyrat e mbledhjes së informatave dhe vlerësimi i tyre, shembuj konkret të përgatitjes së profilit personal, gjurmimi i fondeve nga ana e marrësit dhe nga ana e paguesit si dhe rikthimi i pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme.


Në vijim janë elaboruar burimet ndërkombëtare

në këtë fushë si: Konventa e Këshillit të Evropës për Pastrim, Bastisje Sekuestrimin dhe Konfiskimin e pasurisë së fituar nga krimi dhe Financim të Terrorizmit, si dhe u analizua legjislacioni për pastrim të parave në kontekst të pajtueshmërisë me burimet ndërkombëtare dhe krahasuese me disa vende të BE-së.



Në kuadër të këtij programi trajnues të specializuar, rendësi e veçante i është kushtuar Kripto - valutave, si fenomen i ri në botën moderne dhe zëvendësim i parasë klasike me para virtuale.



Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Prokurorët dhe Gjyqtarët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, duke përfshirë edhe prokurorët Special dhe gjyqtarët e Departamentit Special në të dy nivelet dhe Avokatët Shtetëror.



Vijueshmëria në trajnime në PTV e prezantuar përmes grafikoneve





Kurset e mësimit në distancë-Elearning

Gjatë muajit gusht platforma e mësimit në distancë ka vazhduar të jetë e hapur për pjesëmarrësit e interesuar (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe për studentët e Fakulteteve Juridike) pa afat të caktuar kohor.

Në kuadrin e kësaj platforme janë 18 kurse të çashtme online, 7 prej të cilave edhe në gjuhën serbe.

Më 20 korrik 2020, sipas Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/2019) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 06/2017) është lëshuar online edhe kursi obligativ “Etika profesionale” për gjyqtarët e Republikës së Kosovës.

Për në detaje janë tabelat të cilat prezantojnë vijueshmërinë dhe progresin në ndjekjen e kurseve sipas temës në këtë platformë.

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore</i>	93	61%	31	20%	29	19%
<i>Etika Profesionale I</i>	102	67%	38	25%	13	8%
<i>Etika Profesionale</i>	116	76%	13	8%	24	16%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Serbisht)</i>	10	7%	16	10%	127	83%
<i>Etika Profesionale I (Serbisht)</i>	12	8%	55	36%	86	56%
<i>Etika Profesionale II (Serbisht)</i>	11	7%	35	23%	107	70%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Masat e Diversitetit</i>	3	3%	8	8%	89	89%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi Efektiv</i>	3	18%	12	71%	2	12%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtësia për fëmijë aspekti Civil</i>	16	16%	19	19%	65	65%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtësia për fëmijë aspekti Penal</i>	10	10%	15	15%	75	75%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Hetimi dhe zbulimi i Korrupsionit</i>	11	11%	10	10%	79	79%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar</i>	7	7%	7	7%	86	86%
Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i Gjykatës</i>	13	13%	6	6%	81	81%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Udhëheqësia - Lidershipi</i>	11	11%	9	9%	80	80%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Shqip)</i>	8	8%	18	18%	74	74%
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)</i>	2	22%	3	33%	4	44%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)</i>	19	19%	14	14%	67	67%
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)</i>	2	22%	3	33%	4	44%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i stresit (Shqip)</i>						
<i>Menaxhimi i stresit (Serbisht)</i>	6	67%	3	33%	0	0%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Shqip)</i>	8	8%	8	8%	84	84%
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Serbisht)</i>	2	22%	3	33%	4	44%


Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Shqip)</i>	7	7%	6	6%	87	87%
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Serbisht)</i>	1	11%	3	33%	56	56%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)</i>	12	12%	36	36%	53	52%
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Serbisht)</i>	1	11%	4	44%	4	44%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Anglishtja Ligjore</i>	37	37%	21	21%	42	42%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Teknologjia Informative</i>	31	31%	12	12%	57	57%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Dhuna në Familje (Shqip)</i>						
<i>Dhuna në Familje (Serbisht)</i>	0	0%	3	21%	10	79%



Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>